



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

**KRITERET BAZË PËR OSHC-TË TË CILAT BËJNË NOMINIME, KANDIDATËT
E NOMINUAR DHE OSHC-TË TË CILAT VOTOJNË**

Organizatata e shoqërisë civile (OSHC) të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar duhet të plotësojnë kriteret bazë, si në vijim:

Kriteret për organizatat që nominojnë kandidatë

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OshC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ si dhe rrjetet e OShC-ve (pavarësisht regjistrimit të tyre), të cilat:

1. Janë aktive për të paktën 3 vite;
2. Punën e tyre të deritashme e kanë në përputhje me misionin dhe fushën përkatëse të veprimtarisë;

Përvoja e OshC-së që nominon kandidatë duhet të përshkruhet në seksionin e veçantë të Formularit për Nominim, së bashku me referencat e nevojshme që e dëshmojnë aktivitetin e OShCsë në fushën e caktuar.

Kriteret për kandidatët e nominuar

Të nominuarit duhet të plotësojnë këto parakushte:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën përkatëse për të paktën 3 vite;
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 3 vite të fundit ka fushë të veçantë të veprimtarisë fushën përkatëse.

Kufizimet në procesin e nominimeve

1. Secila OShC mund të nominojë vetëm një kandidat/e.
2. Secila OShC mund të nominojë përfaqësues/e nga vet ajo OSHC.

Procesi i përzgjedhjes dhe votimit

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos-it dhe një përfaqësues i ZQM/ZKM do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos do të njoftojë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për 2 kandidatë nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim.

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Tre kandidatët që marrin më së shumti vota zgjedhen si përfaqësues të OShC-ve në Këshill. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesëve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e ZQM/ZKM.

Kriteret për organizatat që votojnë për kandidatët e nominuar

Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ, të cilat posedojnë Certifikatë të Regjistrimit të OJQ-së.

Mandati i përfaqësuesëve të shoqërisë civile

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur si anëtarë të Këshillit për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile zgjedhen në mandat 2 vjeçar. Para këtij afati, mandati ndërpritet në rastet e mëposhtme:

1. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në Këshill jep dorëheqje;
2. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në Këshill largohet nga sektori i shoqërisë civile;

3. Kur të paktën 51 % të organizatave të cilat kanë marrë pjesë në procesin e votimit kërkojnë nga Kryesuesi i Këshillit që të nisë procedurën e shkarkimit, për shkak të neglizhencës apo mos-përfaqësimit të duhur të interesave të shoqërisë civile në punën e Këshillit;
4. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile nuk merr pjesë në 2 takime të njëpasnjëshme të Këshillit, pa arsye.